



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1201/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Ahmet Krasniqi, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së në Klinë, paraqitur kundër Qendrës të Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Ahmet Krasniqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Klinë, nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:10 nga Ahmet Krasniqi kandidat për anëtar të kuvendit komunal, ku ka pretenduar se është tjetërsuar vota e tij nga komisionerët gjatë numërimit të votave në këto qendra të votimit: Nr. 0802C në Drenoc, Nr. 0814C në Shtupel, Nr. 0814C në Gllarevë.

Ankuesi kërkon që të bëhet rinumërimi i këtyre vendvotimeve me nr:0802C/01R, 08020/02R, 0802C/03D, 0814C/01R dhe 0808C/0R thuhet në ankesën e pretenduesit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën gjeti se:

#### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet e kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së, Ahmet Krasniqi janë të pa argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi bindëse me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

Anr. 1201/2013 më datën 06.12.2013.



**Kryesuesi i Panelit  
Ferit Osmani**

***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.